


VENDIM
Nr.3, datë 28.12.2006
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
PELIKANI SECURITY Shpk



Sot më datë 28 Dhjetor 2006, unë i nënshkruari Vesel DEMIRAJ në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë Pelikani Security Shpk., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar me vendim nr.26273, datë 17.09.2001 të Gjykatës së Rrethit Tiranë me seli në Tiranë

VEREJ SE

Me vendimin e ortakut të vetëm Nr.2, datë 30.11.2006 është vendosur:

1. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë me fitimin e pashpërndarë të realizuar pas tatimit deri në vitin 2005;
2. Caktimin e ekspertit Znj. Esmeralda BALLUKU, ekspert kontabël i miratuar me nr. License 12, datë 10.02.2000, për përgatitjen e raportit të vlerësimit të rezervave dhe fitimeve të pashpërndara që janë gjendje deri në përfundim të vitit financiar 2005 me qëllim rritjen e kapitalit fillestar të shoqërisë Pelikani Security Shpk.
3. Depozitimin e këtij vendimi në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me Vendimin Nr.26273/5, datë 27.12.2006, Gjyqtari i Vetëm Mariana DEDI ka vendosur depozitimin në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të vendimit të lartpërmendur të Ortakut të Vetëm.

Pas përgatitjes së raportit të sipërpërmendur nga Eksperti i caktuar Znj. Esmeralda BALLUKU, dhe pasi e gjeta të saktë dhe në përputhje me ligjin përfundimet e nxjerra nga ai

VENDOSA

1. Miratimin e Raportit të datës 27.12.2006 të ekspertit Znj. Esmeralda BALLUKU për vlerësimin e rezervave dhe fitimeve të pashpërndara me qëllim rritjen e kapitalit fillestar të shoqërisë Pelikani Security Shpk.

2. Zmadhimin e kapitalit fillestar të shoqërisë me fitimin e pashpërndarë pas tatimit të vitit 2005 nga 4.000.000 lekë në 11.584.000 lekë;
3. Vlera nominale e pjeseve të kapitalit fillestar bëhet nga 40.000 (dyzetë mijë) Lekë secila në 115.840 Lekë secila.
4. Ky kapital zotërohet në masën 100% nga unë ortak i vetëm Vesel DEMIRAJ.
5. Depozitimin e këtij vendimi në Zyrën e Rregjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Shoqëria PELIKANI SECURITY Shpk
Vesel DEMIRAJ

Ortak i Vetëm

Vesel Demiraj
